

Tiranë, 29.03.2018

Drejtuar: Z. Bledi Çuçi, Z. Oerd Bylykbashi
Bashkëkryetarë të Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore
Kuvendi i Shqipërisë

Objekti: Rekomandime mbi reformën zgjedhore

Të nderuar deputetë,

Akademia e Studimeve Politike (ASP) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2009, nën kujdesin e Këshillit të Evropës. Aktiviteti i saj fokusohet në dy drejtime kryesore: trajnime dhe rritje e kapaciteteve, si dhe kontributi me ekspertizë në proceset demokratike dhe reformuese në Shqipëri.

Në kuadër të asistencës për zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri të Këshillit të Evropës, ASP është angazhuar që prej vitit 2011 në edukimin e votuese të rinj, në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Arsimit. Programi i edukimit mbi zgjedhjet ka targetuar çdo vit zgjedhor rreth 35 mijë votues për herë të parë (maturantë), në të gjitha shkollat e mesme publike të vendit, duke i informuar ata mbi rëndësinë e zgjedhjeve, por edhe praktikuar nëpërmjet ushtrimit praktik procesin e votimit, me qëllim evitimin e fenomeneve negative si votimi familjar apo shit-blerja e votës.

Në zgjedhjet e 25 qershorit 2017, ASP bëri të mundur gjithashtu edukimin zgjedhor nëpërmjet teknologjisë së informacionit nëpërmjet ndërtimit për herë të parë të një aplikacioni për telefonat smartphone, të quajtur "VOTO 2017". Aplikacioni u lidh me databazën e votuesve si dhe faqen zyrtare të KQZ duke krijuar mundësinë për marrjen e informacionit për listën e zgjedhësve, qendrën e votimit dhe vendodhjen e saj; informacion për administrimin e procesit zgjedhor, për ditën e zgjedhjeve, procesin e numërimit dhe rezultatet. Një risi mjaft e rëndësishme ishte dhe ofrimi i mundësisë për qytetarët për raportimin në kohë reale përmes fotografive apo videove për mashtrime elektorale, intimidimin e votuesve apo praktika të tjera të kundraligjshme. Në përfundim të procesit zgjedhor, u raportuan në qendrën e operatorëve të ngritur pranë KQZ-së rreth 244 denoncime për shkelje apo abuzime të ndryshme. 47 nga këto raportime u

përgatit brezin e ri të liderëve

konsideruan më të rëndësishme për t'u regjistruar dhe transmetuar për verifikime të mëtejshme.

Në dhjetor 2016 ASP u komisionua nga Prezenca e OSBE për të përgatitur "Vlerësimin e nevojave për edukim dhe informim zgjedhor në Shqipëri" duke zhvilluar një sondazh me mbi 1.200 autoritete vendore, vëzhgues zgjedhore, minoritete dhe grupeve të tjera specifike shoqërore. Gjetjet e këtij studimi ishin me interes për të kuptuar problematikën që haset në informimin e votuesve si dhe administrimin nga trupa zgjedhore.

Duke u mbështetur në këtë eksperiencë disavjeçare dhe në vijim të ftesës për t'u përfshirë në procesin e konsultimit dhe mendimeve të shprehura në seancën dëgjimore të datës 9 mars 2018, dëshirojmë të dorëzojmë pranë komisionit tuaj disa rekomandime të mëtejshme me fokus përmirësimin e procesit të administrimit zgjedhor, në kontekstin e një reforme të pritshme zgjedhore.

Me respekt

Erjon Tase

Drejtor Ekzekutiv

REKOMANDIME MBI REFORMËN ZGJEDHORE

Mars 2017

Rekomandimet e Akademisë së Studimeve Politike fokusohen në ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor dhe kuadrin e mëtejshëm ligjor me qëllim rritjen e profesionalizmit të trupës zgjedhore, sigurimin e të drejtës së votës si një e drejtë themelore, por edhe adresimin dhe ndëshkimin ligjor ndaj abuzimeve dhe presioneve ndaj votuesve.

Më konkretisht sugjerojmë:

- 1. Ngritjen e një Qendre Trajnimi pranë KQZ me qëllim rritjen e profesionalizmit të trupës zgjedhore. Kjo duhet shoqëruar me rregullime ligjore për të kthyer certifikimin nga kjo qendër si kusht për t'u regjistruar si komisioner në zgjedhje.**

Trajnimet aktuale të trupës zgjedhore zhvillohen nga KQZ¹ me synim njohjen e Kodit Zgjedhor dhe procedurave përkatëse për administrimin e procesit. Për shkak të vonesave në emërimin e komisionerëve nga partitë politike, është faktuar në disa zgjedhje të fundit se këto trajnime nuk zhvillohen në kohën dhe cilësinë e duhur. Si rrjedhojë, konstatohen mangësi që mund të dëmtojnë besueshmërinë e procesit, por edhe konflikte të panevojshme mes komisionerëve në zbatimin e procedurave.

Raporti vjetor² i KQZ për vitin 2017 vë në dukje faktin shqetësues të mungesës së trajnimit të trupës zgjedhore në të gjitha nivelet, si më poshtë vijon:

¹ [Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, për zgjedhjet e Kuvendit të datës 18 qershor 2017](#)

² [Raport për Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 Janar – 31 Dhjetor 2017](#)

përgatit brezin e ri të liderëve

- 1.7.3 Ngritja dhe funksionimi i KZAZ-ve

Në bazë të kërkesave të partive politike u zëvendësuan 131 ose 18% e anëtarëve të KZAZ-ve pasi ishin zhvilluar trajnimet;

- 1.7.4 Ngritja dhe funksionimi i KQV-ve

...katër ditë para ditës së zgjedhjeve, 24 KZAZ nuk kishin emëruar ende anëtarët e KQV-ve për shkak të mosparaqitjes së propozimeve nga partitë politike. Sjellja e partive politike duke paraqitur propozime në tejkallim të skajshëm të afateve ligjore, çënoi jo vetëm realizimin e trajnimeve nga KQZ, por edhe organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor...

- 1.8.2 Zhvillimi i trajnimeve të GNV

vetëm "84% e anëtarëve të Grupeve të Numërimit u arrit të trajnoheshin mbi procedurat e punës së tyre. Për më tepër, edhe ky trajnim u krye në Vendet e Numërimit të Votave përpara fillimit të numërimit".

Një zgjidhje për këtë problematikë të përsëritur nga partitë politike do të ishte **ngritja e një Qendre Trajnimi pranë KQZ**, e cila do të sigurojë trajnimin e vazhdueshëm të komisionerëve përtej vitit zgjedhor. Pjesëmarrja në këto trajnime mund të shoqërohet me një certifikim përkatës që akrediton njohuritë e komisionerëve mbi procesin zgjedhor.

Për t'i dhënë rëndësinë e duhur këtij certifikimi është i nevojshme ndërhyrja ligjore në Kodin Zgjedhor me qëllim përcaktimin e këtij **certifikimi si kusht për t'u regjistruar si komisioner**. Ky formalizim do të jetë një hap i mëtejshëm drejt krijimit të një trupe profesionale zgjedhore si dhe krijimit të një databaze të komisionerëve me integritet dhe të papërfshirë në krime të mëparshme elektorale dhe penale në përgjithësi.

2. Rregullime të nevojshme ligjore për të përcaktuar qartësisht institucionet, të cilat duhet të ndjekin ankesat për shkeljen e së drejtës së votimit si dhe ndëshkimin për abuzimet me votën.

Kodi Zgjedhor shqiptar parashikon të drejta specifike ankimore për partitë dhe kandidatët (regjistrimi i të cilëve është refuzuar), por nuk e shtrin këtë të drejtë thelbësore tek votuesit. Kodi nuk parashikon të drejtë ankimi për votuesit që u kufizohet e drejta e votës si dhe nuk është specifikuar mundësia për një zgjidhje efektive³.

³ [Ardita Driza Maurer – "Studim mbi vlerësimin e nevojave për edukim dhe informim zgjedhor në Shqipëri", faqe 38](#)

përgatit brezin e ri të liderëve

E drejta ndërkombëtare për mjetet juridike efektive nënkupton që ankesat duhet të jenë "të arritshme" nga individët dhe grupet. Mjetet juridike efektive përfshijnë "dëmtshpërblim, i cili mund të përfshijë zhdëmtimin dhe rehabilitimin", "garanci për mospërsëritje" dhe "ndëshkimin e fajtorëve". Këto të drejta parashikohen nga Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)⁴, në Nenin 2, pika 3 si dhe Nenin 25, si dhe në instrumenta të tjera ndërkombëtare, ku vendi ynë është pjesë.

Në këtë këndvështrim rekomandojmë që të kryhen rregullime të nevojshme në Kodin Zgjedhor që të **parashikojnë qartësisht të drejtën e votuesit për t'u ankuar dhe procedurën që duhet ndjekur** (siç e parashikon për kandidatët dhe partitë). Është e vërtetë që e drejta e votimit parimisht ekziston e parashikuar në Kushtetutë dhe Konventat ndërkombëtare (shiko paragrafin e fundit në faqen 38 të studimit që cituar në shënimin nr. 3), por megjithatë rekomandohet që të përcaktohet qartësisht në Kodin Zgjedhor si më poshtë vijon:

- a) Një informacion i qartë (nga ana e KQZ) mbi të drejtën e votuesve për t'u ankuar, ku, si, brenda cilave afate, etj,.... (shiko paragrafin e parë në faqen 39 të studimit);
- b) Ndjekje ligjore e shkeljes së të drejtës së votimit deri në ndëshkimin përkatës për këtë shkelje. Këtu janë problematike jo vetëm mungesa e hetimit dhe ndjekjes së denoncimeve, por edhe (kryesisht) puna e gjykatës që duhet ta çojë procesin deri në fund.

Bazuar në eksperiencën e denoncimeve të mbërritura nga qytetarët në aplikacionin mobile "Voto 2017", në lidhje me intimidimin e votuesve apo praktika të tjera të kundraligjshme, vihet re një **vakum kompetencash dhe bashkërendimi të institucioneve për të hetuar** më tej denoncimet. Eksperiencia ka dëshmuar se denoncimet mbi këto shkelje në media apo pranë KQZ nuk janë ndjekur më tej nga organet ligjzbatuese dhe nuk ka patur ndëshkime të fajtorëve, duke çuar në përsëritjen e abuzimeve në zgjedhjet pasardhëse. Nuk mjafton vetëm rritja e masës ndëshkuese për nene të caktuara në Kodin Penal, por edhe zbatimi i këtyre neneve për të arritur rezultatet e kërkuara.

Në këtë aspekt, rekomandojmë që të **forcohet struktura dhe kompetencat e KQZ në dokumentimin e denoncimeve** të mbërritura mbi shkeljen e të drejtës së votës apo abuzime të tjera. Një rregullim i mëtejshëm në këtë drejtim, mund të jetë edhe **ngritja e strukturave të përbashkëta apo task-force dhe shkëmbimi i informacionit** (KQZ-

⁴ [International Covenant on Civil and Political Rights \(ICCPR\)](#) UNITED NATIONS, 1966

përgatit brezin e ri të liderëve

Prokurori-Ministria e Brendshme) në periudhën zgjedhore, në mënyrë që të evidentohen në kohë denoncimet dhe t’i jepet zgjidhje problematikave.

Këto qartësime në Kodin Zgjedhor mund të ndihmojnë në adresimin më të mirë të pasaktësive në listat zgjedhore, por edhe veprime të tjera që synojnë të pengojnë qytetarët të shprehin vullnetin e tyre. Gjithashtu, ky është një hap shumë i rëndësishëm për të ndërtuar besimin në zgjedhje.

3. Përdorimi i teknologjisë së informacionit për të rritur informimin si dhe ofruar një mundësi të mëtejshme për të raportuar presionet dhe abuzimet me votën.

Nën shembullin e aplikacionit mobile “Voto 2017”⁵, si mjet në dispozicion të zgjedhësve për të marrë informacion zgjedhor dhe ku mund të kryhen raportime për raste të cënimit të votës, **inkurajojmë përdorimin e mëtejshëm të teknologjisë së informacionit dhe aplikacioneve në dispozicion të administrimit të procesit zgjedhor**. Këto teknologji, të mbrojtura nga sistemet e duhura të sigurisë, mund të ndihmojnë në transparencën e procesit, edukimin e votuesve dhe trupës zgjedhore, por edhe mund të jenë një mjet i mëtejshëm për të siguruar denoncimet e presioneve dhe shkeljeve gjatë procesit zgjedhor.

Tiranë, 29 mars 2018

⁵ [Raporti final i fushatës së edukimit të votuesve për herë të parë në zgjedhjet 2017](#)